



ISTITUTO COMPRENSIVO DI CIVIDALE DEL FRIULI

Scuole dell'Infanzia, Primarie e Secondaria di I° Grado dei Comuni di: Cividale del F., Prepotto e Torreano
Via Udine n. 15/2 – 33043 Cividale del Friuli – UD -

Cod. Meccanografico UDIC851001– C.F.: 94127320300

Codice Univoco Fatturazione Elettronica: UFKDDE - Codice univoco IPA: istsc_udic851001

Tel.: 0432/733835 – E-mail: udic851001@istruzione.it - Pec: udic851001@pec.istruzione.it

[Sito web: www.icciviale.edu.it](http://www.icciviale.edu.it)

SESIONI PRANVEROR

KOPSHTI “ANTONY DAVID LIBERALE” NE RUALIS

Ruga Tombe Romane 5, 33043 Cividale del Friuli (UD)

Në sesionin pranveror mund të regjistrohen të gjithë fëmijët që mbushin 2 vjeç (24 muaj) gjatë vitit shkollor.

Hapësirat e sesionit pranveror

Një koridor i gjerë me rafte për pritjen e fëmijëve; hapësire dedikuar leximit dhe aktiviteteve grafike - pikturë; klasa për aktivitete edukimi, eksperimente e lojra; dhoma gjumi për pushimin e pasdites; sala e ngrënjes dhe klasa për aktivitetin fizik e përbashkët me kopshtin; Banjot për fëmijë.

Përfundimisht shkolla ka dy oborre me lodra të sigurta sipas kriterëve të ligjit.

Orari shkollor

Nga e hëna në të premten, nga ora 7:45 deri në orën 16:00 (41,5 orë javore) sipas orareve në vijim:

Orari i hyrjes 7:45-9:00; Pushimi 9:15/9:45; Dreka 12:00/13:00; Orari i parë i daljes 13:15; Orari i dytë i daljes 15:45/16:00.

Shërbime

Ofrohet shërbimi i mensës vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Cividales.

Kontakte

Telefoni: 0432/730847

Email: infanzia.rualis@icciviale.edu.it (coord.serviziociviale@proges.it)

KOPSHTI “VITTORIO PODRECCA” NE CIVIDALE

Ruga De Gasperi 1, 33043 Cividale del Friuli (UD)

Hapësirat

Ndërtesa ka koridorin, hyrjen me rafte, katër klasa, salloni i përbashkët për aktivitete fizike, banjo, sallën e mësuesve, sallën e madhe të ngrënjes dhe guzhinen. Përfundimisht shkolla ka dy oborre të gjerë me lodra të ndryshme sipas kriterëve të ligjit.

Orari shkollor

Nga e hëna në të premten, nga ora 8:00 deri në orën 16:00 (40 orë javore), sipas orareve të mëposhtme:

Pranimi i fëmijëve para orarit 7:45 – 8:00; Orari i hyrjes 8:00 – 9:00; Orari i parë i daljes 13:00; Orari i dytë i daljes 15:45/16:00.

Shërbime

Ofrohet shërbimi i transportit me autobus, hyrja para orarit (7:45 – 8:00) dhe mensa vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Cividales.

Kontakte

Telefoni: 0432/700005 Email: infanzia.podrecca@icciviale.edu.it

KOPSHTI “ANTONY DAVID LIBERALE” NE RUALIS
Ruga Tombe Romane 5, 33043 Cividale del Friuli (UD)

Hapësirat

Ndërtesa ka një koridor të madh, tre salla me shumë funksione dhe për pritjen e fëmijëve, katër klasa me banjo, klasa për edukimin fizik, laborator, salla e mensës, ambjent me shumë funksione që përdoret si zyrë, por edhe si bibliotekë për fëmijët.

Përfshihet gjenden dy oborre me lodra sipas kriterëve të ligjit.

Orari shkollor

Nga e hëna në të premten, nga ora 8:00 deri në orën 16:00 (40 orë javore), sipas orareve të mëposhtme:

Hyrja para orarit 7:45 – 8:00; Orari i hyrjes 8:00 - 8:30; Orari i daljes pa drekë 11:45 - 12:00; Orari i parë i daljes 13:15; Orari i dytë i daljes 15:45 – 16:00.

Shërbime

Ofrohet shërbimi i transportit me autobus dhe mensa, vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Cividales. Ndërsa hyrja para orarit (7:45 – 8:00) është një shërbim që drejtohet dhe ofrohet falas nga edukatorët.

Kontakte

Telefoni: 0432/730847 Email: infanzia.rualis@iccidale.edu.it

KOPSHTI “GIOVANNI LORENZONI” NE GAGLIANO
Ruga della Chiesa 33- 33043 Cividale del Friuli (UD)

Hapësirat

Ndërtesa është e vogël, por e organizuar shumë mirë, përbëhet nga dy klasa, salloni me shumë funksione, mensa, banjo.

Shkolla rrethohet nga një oborr i madh me lodra sipas kriterëve të ligjit dhe hapësira të menduara posaçërisht për fëmijët. Pozicioni, në qendër dhe shumë afër realitet të fshatit ofron mundësi për të organizuar dalje, për të marrë nisma vëzhgimi, eksplorimi dhe zbulimi, paraqet siguri një vlerë të shtuar.

Orari shkollor

Nga e hëna në të premten, nga ora 8:00 deri në orën 16:00 (40 orë javore), sipas orareve të mëposhtme:

Hyrja para orarit 7:45 – 8:00; Orari i hyrjes 8:00 - 8:30; Orari i parë i daljes 13:15 - 13:30; Orari i dytë i daljes 15:45 – 16:00.

Shërbime

Ofrohet shërbimi i transportit me autobus, hyrja para orarit (7:45 – 8:00) dhe mensa vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Cividales.

Kontakte

Telefoni: 0432/700528 Email: infanzia.gagliano@iccidale.edu.it

KOPSHTI “FRANCESCO MUSONI” NE SANGUARZO
Ruga San Floreano 2, 33043 Cividale del Friuli (UD)

Hapësirat

Ndërtesa në katin poshtë ka një klasë të pajisur mirë dhe me shumë dritë, disa banjo dhe mensën. Ndërsa në katin e sipërm gjendet klasa e dytë, një zyrë e vogël kushtuar bibliotekës, një palestër, disa banjo dhe një ashensor.

Shkolla ka një oborr të madh me shumë lodra sipas kriterëve të ligjit dhe një tendë të fiksuar mirë.

Orari shkollor

Nga e hëna në të premten, nga ora 8:00 deri në orën 16:00 (40 orë javore), sipas orareve të mëposhtme:

Hyrja para orarit 07:45; Orari i hyrjes 8:00; Orari i parë i daljes 13:00; Orari i dytë i daljes 15:45 – 16:00.

Shërbime

Ofrohet shërbimi i shoqërimit me autobus, hyrja para orarit dhe mensa, vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Cividales.

Kontakte

Telefoni: 0432/701179 Email: infanzia.sanguarzo@iccidivale.edu.it

KOPSHTI “ELENA LO DUCA” NE PREPOTTO

Rruga Brolo 39, 33040 Prepotto (UD)

Hapësirat

Shkolla është shumë e madhe, me dritë, e pajisur me tabelen LIM në klasë dhe me oborr të gjerë, të rrethuar dhe i pajisur mirë.

Orari shkollor

Nga e hëna në të premten, nga ora 8:15 deri në orën 16:15 (40 orë javore), sipas orareve të mëposhtme:

Orari i hyrjes 8:15 – 8:45; Orari i parë i daljes 13:30; Orari i dytë i daljes 16:00 – 16:15

Shërbime

Ofrohet shërbimi i shoqërimit me autobus dhe mensa, vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Preptos. Shërbimi i shoqërimit me autobus përfshin edhe Komunen e Cividales.

Kontakte

Telefoni: 0432/713103 Email: infanzia.prepotto@iccidivale.edu.it

KOPSHTI “MONUMENTO AI CADUTI” NE TORREANO

Rruga Principale 18, 33040 Torreano (UD)

Hapësirat

Shkolla përbëhet nga dy kate. Në katin e parë gjenden dy klasa të gjera e funksionale, të organizuara në mënyrë të tillë që fëmijët të jenë të lirë të lëvizin dhe të luajnë, banjo për fëmijë dhe për ata me aftësi ndryshe, një sallon shumë i madh me disa funksione ku do të praktikohet edhe aktiviteti fizik. Në katin sipër gjendet një dhomë e ndriçuar që do perdoret si laborator, një sallë e vogël për mësuesit dhe mensa afër guzhines.

Përgjithësisht janë dy oborre me lodra sipas kritereve të ligjit dhe të rrethuar.

Orari shkollor

Nga e hëna në të premten, nga ora 8:00 deri në orën 16:00 (40 orë javore), sipas orareve të mëposhtme:

Hyrja para orarit 07:45 – 8:00; Hyrja 8:00 – 8:30; Orari i parë i daljes 13:15 – 13:30; Orari i dytë i daljes 15:45 – 16:00.

Shërbime

Ofrohet shërbimi i shoqërimit me autobus dhe mensa, vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Torreanos.

Kontakte

Telefoni: 0432/712069 Email: infanzia.torreano@iccidivale.edu.it

SHKOLLA FILLORE “ALESSANDRO MANZONI” NE CIVIDALE

Piaca XX Settembre 1, 33043 Cividale del Friuli (UD)

Hapësirat

Shkolla pozicionohet në qendër të Cividales dhe është rinovuar kohët e fundit. Ndërtesa ka dy kate; përbëhet nga njëmbëdhjetë klasa me pajisje të reja dhe me tabela LIM (gjashtë për mësimet e zakonshme dhe pesë për mësimet në grupe të vogla) dhe me hapësira të përshtatshme për fëmijët që kanë nevojë për

mësues ndihmës; në pjesën e poshtme gjendet mensa, e ndarë në dy pjesë. Shkolla është e madhe dhe me shumë dritë, me një oborr të gjerë që përdoret për aktivitete kreative. Afër shkolles është një palestër e pajisur me të gjitha mjetet.

Orari shkollor

Orari është i plotë (40 orë javore). Nga e hëna në të premten, nga ora 7:55 deri në orën 15:55 sipas orareve të mëposhtme:

Paradite 7:55 – 12:35; Mensa dhe pas mense 12:35-13:55; Pasdite 13:55 – 15:55

Shërbime

Ofrohet shërbimi i shoqërimit me autobus, hyrja para orarit (nga ora 7:30 deri në orën 7:50) dhe mensa, vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Cividales.

Shkolla ofron edhe shërbimin e aktiviteteve pas orarit shkollor falas nga ora 16:15 deri në orën 17:45 të hënën, të martën, të enjten dhe të premten.

Kontakte

Telefoni: 0432/731194 Email: primaria.manzoni@iccividaledu.it

SHKOLLA FILLORE “JACOPO TOMADINI” NE RUALIS **Rruga Buonarroto 1, 33043 Cividale del Friuli (UD)**

Hapësirat

Ndërtesa e rinovuar kohët e fundit, ndodhet në një vend të qetë dhe ka vetëm një kat. Është moderne, mikpritëse dhe funksionale. Klasat janë të pajisura me tabelat LIM, shumë të ndriçuara dhe me dyer që lejojnë daljen direkte në oborr. Shkolla ka hapësira të gjëra brenda, bibliotekën dhe palestren me kapacitet të madh. Mensa e gjerë, mikpritëse dhe e organizuar shumë mirë, ndodhet në katin nën tokë. Ndërtesa, me dalje të shpejta dhe të sigurta, ka hapësira të mëdha jashtë me gjelbërim dhe të rrethuar mirë. Afër shkolles ndodhet parku i Rualis: vend i gjelbërt me shumë loda për fëmijë, fushë basketbolli dhe futbollit.

Orari shkollor

Orari është i plotë (40 orë javore). Nga e hëna në të premten, nga ora 8:15 deri në orën 16:15 sipas orareve të mëposhtme:

Paradite 8:15 – 12:55; Mensa e pas menses 12:55 – 14:15; Pasdite 14:15 – 16:15.

Shërbime

Ofrohet shërbimi i shoqërimit me autobus, hyrja para orarit (nga ora 7:30 deri në 8:10) dhe mensa vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Cividales.

Shkolla vë në dispozicion falas shërbimin e aktiviteteve pas orarit shkollor nga ora 16:15 deri në 17:45 të hënën, mërkurën – enjten – premten.

Kontakte: 0432/732576 Email: primaria.tomadini@iccividaledu.it

SCUOLA PRIMARIA “DANTE ALIGHIERI” DI PREPOTTO **Via XXIV Maggio, 19, 33040 Prepotto (UD)**

Hapësirat

Ndërtesa është rinovuar kohët e fundit, përbëhet nga dy kate dhe një oborr të madh. Ka 6 klasa të gjëra me shumë dritë dhe me tabela LIM: në katin e parë tre klasa përdoren për mësim, në katin e dytë është biblioteka, laborator i informatik dhe 2 klasa të tjera.

Në afërsi të shkolles ndodhet një fushë sportive që përdoret për aktivitete kreative dhe sporte.

Orari shkollor

Nga e hëna në të premten, nga ora 8:15 deri në 16:15 (40 orë javore), sipas orareve të mëposhtme:

Paradite 8:15 – 12:45; Mensa e pas menses 12:45 – 14:15; Pasdite 14:15 – 16:15

Shërbime

Ofrohet shërbimi i aktiviteve pas orarit shkollor, pranimi i fëmijëve para orarit (nga ora 7:30 deri në 8:10 me kërkesë nga prindërit) dhe mensa, vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Preptos. Shoqërimi me autobus bëhet në gjithë komunën e Preptos, në Gagliano dhe Komunitat e Dolegna del Collio e Premariacco.

Kontakte

Telefoni: 0432/713191 Email: primaria.prepotto@icciviale.edu.it

SHKOLLA FILLORE “VITTORIO ALFIERI” NE TORREANO

Rruga Delle Scuole 9, 33040 Torreano (UD)

Hapësirat

Shkolla pozicionohet në një vend të qetë, e rrethuar me gjelbërim, afër përroit Chiarò. Organizohet në dy kate, është e gjerë dhe me shumë dritë, ka 5 klasa të pajisura me orë të reja dhe tabela LIM, laborator informatik, bibliotekë, sallën të madhë për aktivitete, mensë. Oborri është i madh, i rrethuar me shumë pemë e lule të përshtatshme për pushimet jashtë.

Edukimi fizik zhvillohet në strukturën e qendrës me shumë funksione që është e pajisur me mjetet e palestres.

Orari shkollor

Orar i zgjatur (30 orë javore). Të hënën, të mërkurën dhe të premten nga ora 8:00 deri në orën 16:30, të martën dhe të enjten nga ora 8 deri në 12:30.

Dreka nga ora 13:00 deri në 14:30 menaxhohet nga edukatore të një kooperative.

Shërbimet

Ofrohen sipas kërkesave të prindërve dhe regjistrimit më përpara në Komunen e Torreanos, shërbimet e shoqërimit me autobus, pranimit të fëmijës (nga ora 7:30 deri në 7:55), shërbimi i mensës dhe qëndrimi i fëmijës pas orarit shkollor (të martën dhe të enjten). Shoqërimi me autobus përfshin territorin e komunes dhe arrijnë edhe në Cividale del Friuli ku, nëse kërkohet, bën dy ndalesa në stacionin e trenit dhe autobuzave dhe në Qendrën e studimit në rrugën Gemonà.

Kontakte

Telefoni: 0432/712170 Email: primaria.torreano@icciviale.edu.it

SHKOLLA 8-VJECARE “ELVIRA E AMALIA PICCOLI”

Rruga Udine 15/2, 33043 Cividale del Friuli (UD)

Hapësirat

Ndërtesa, plotësisht antisizmike, me gjurmë anglo-saksone në projektimin e saj ka një oborr të gjerë rreth të cilit ndodhen klasat dhe ambiente të tjera; çdo klasë ka dalje në rast rreziku në oborr. Klasat ndahen në blloqe me nga katër, nëpër dy katet, e çdo kat ka banjo. Gjenden klasa të ndryshme të vecanta: laborator dhe klasa e shkencës, dy klasa informatike, laborator i muzikës, artit, teknologjisë dhe robotikës, Palestra e madhe e pajisur me të gjitha mjetet, biblioteka, mensa, një auditor me shumë vende; zyrat e administratës dhe drejtorja.

Ambjentet janë të gjera dhe të ndriçuara mirë, me shumë vetura dhe dritare të mëdha me pamje nga oborri. Oborri i gjerë ka pistën e atletikës dhe shkolla është e rrethuar nga një park me pemë shekullore, një pjesë e të cilit përdoret si kopsht perimesh dhe serë.

Orari shkollor

Shkolla jonë ofron tre mundësi: orarin normal, të zgjatur dhe degen e muzikës.

• Orari shkollor normal

Për këtë orar shkollor parashikohen 30 orë javore: nga e hëna në të premten, nga ora 8:00 deri në orën 14:00.

• Orari shkollor i zgjatur

Parashikohen 37 orë javore (prej të cilave 4 janë në mensë dhe 3 për aktivitete me dy mesues të lëndave të ndryshme: nga e hëna në të enjten nga ora 8:00 deri në 16:00, të premten nga ora 8:00 deri në 13:00

• Dega e muzikës

Parashikohen 39 orë në javë (prej të cilave 4 janë në mensë, 2 orë për aktivitete me disa mesues e 3 për aktivitete studimi/praktikë të veglës muzikore, që zgjidhet midis pianos, klarinetes, kitarres dhe instrumentave me goditje: Të hënën 8:00 – 17:00, nga e martja në të enjten 8:00 – 16:00, të premten 8:00 – 14:00

Shërbime

Ofrohet shërbimi i hyrjes në shkollë para orarit dhe mensa, vetëm nëse më përpara bëhet regjistrimi në Komunen e Cividales.

Kontakte

Telefoni: 0432/733835 Email: UDIC851001@istruzione.it